



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

## UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.44, datë 27.05.2021

**(Për hetimin, ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës mbi bazë gjinore, ndaj të miturve dhe dhunës në familje)**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 43 dhe 46 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar, ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, ligjit nr. 7895 datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, ligjit nr.7905 datë 27.04.1995 “Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.17 dt.13.12.2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave,dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje” të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;

**KONSTATOJ:**

Nga vështrimi i ushtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë mbi disa problematika të hasura kohët e fundit në lidhje me mënyrën e hetimit dhe ndjekjen penale të veprave penale kundër dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve dhe dhunës në familje konstatohet se:

- Në mjaft raste në veprimet e para hetimore nuk janë zbatuar me rigorozitet detyrimet ligjore në marrjen e masave për mbrojtjen e viktimave;
- Mungon komunikimi korrekt ligjor ndërmjet oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të gatshëm për raportimin e veprave penale kundër dhunës me bazë gjinore, të miturve dhe dhunës në familje;
- Nuk janë kryer të gjitha veprimet e mundshme procedurale për dokumentimin e rasteve dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të veprave penale, si dhe rast pas rastit, sipas rrezikshmërisë së veprës apo të autorit nuk janë marrë masat e nevojshme të sigurimit për autorët e veprave penale;
- Në disa raste masat e dënimit të kërkuara nga prokurorët për autorët e veprave penale kundër dhunës me bazë gjinore, veprat ndaj të miturve dhe dhunës në familje nuk përshtaten me rrezikshmërinë e veprave penale apo autorëve të tyre, duke sjellë si pasojë që dënimi të mos jetë efektiv, proporcional dhe frenues që të kontribuojë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të këtyre formave sensitive të kriminalitetit ndaj viktimave gra apo viktimave të dhunës në familje.
- Duke qënë se nga disa prokurorë dhe oficerë të kësaj prokurorie vijon të mos zbatohen rigorozisht detyrimet që lidhen me rolin e Koordinatorit për Subjektet me Status të Posaçëm të përcaktuara në Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 05, datë 26.10.2018 për “Garantimin e Asistencës ndaj Viktimave dhe Dëshmitarëve të Veprave Penale” të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Urdhërin nr.27, datë 27.04.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë “Mbi rolin e Koordinatorit për Subjektet me Status të Posaçëm”.

Sa më sipër me qëllim ushtrimin e funksionit të drejtuesit të prokurorisë, forcimin e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe zgjidhjen e problematikave të hasura deri më sot në lidhje me mënyrën e hetimit dhe ndjekjen penale të veprave penale kundër dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve dhe dhunës në familje;

### **UDHËZOJ :**

1. Në rastet e kallëzimeve penale apo ngjarjeve kriminale që kanë të bëjnë me vepra penale të dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve apo që kanë të bëjnë me dhunën në familje oficerët e policisë gjyqësore duhet që:

- Për çdo rast pas fillimit të kryerjes së veprimeve të para hetimore të njoftojnë menjëherë prokurorët e gatshëm të seksioneve përkatëse duke i vënë në dijeni për secilin rast, komunikim i cili duhet të vazhdojë deri në momentin e arrestimeve në flagrancë apo ndalimeve me iniciativë të mundshme, si dhe referimin e rastit në prokurori.
- Për çdo rast, në kryerjen e veprimeve të para hetimore, të bëjnë të mundur mbledhjen provave materiale dhe pyetjen e të gjithë dëshmitarëve të mundshëm, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Në rastet e veprave penale të kryera ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore apo të mitur, vepra penale për të cilat në bazë të parashikimeve të Seksionit i V "Përgjimet" të K.Pr.Penale, lejohet dhe përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, të i nformojnë menjëherë prokurorët e gatshëm për mundësinë e realizimit të këtyre veprimeve procedurale.

2. Gjatë fazës së hetimeve paraprake, punonjësi i policisë gjyqësore respekton dhe zbaton të drejtat e viktimës, bazuar në Kodin e Procedurës Penale. Për ushtrimin e kësaj përgjegjësie, punonjësi i policisë gjyqësore vepron vetë ose nën udhëzimet e prokurorit. Në mënyrë të veçantë, punonjësi i policisë gjyqësore:

- a) të marrin kontaktin e parë me viktimën e dyshuar dhe sigurohen që asaj, veçanërisht nëse u përket kategorive vulnerabël, t'i plotësohen nevojat urgjente dhe t'i garantohet siguria fizike. Për këtë qëllim, policia gjyqësore bashkëpunon me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare, sipas rastit;
- b) t'i japin viktimës së dyshuar i nformacionin e parë lidhur me të drejtat e saj dhe me mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale dhe e vendos në kontakt me shërbimin social në nivel vendor, si edhe me ofrues joqeveritarë të shërbimeve, nëse është rasti;

c) të marrin kallëzimin ose deklaratimet e viktimës, duke respektuar rregullat e parashikuara në KPP dhe në këtë udhëzim;

ç) t'i raportojë prokurorit lidhur me kontaktin me viktimën, si edhe periodikisht ose me kërkesën e prokurorit për aktivitetin e tij të mëvonshëm lidhur me viktimën. Raportimi është i detyrueshëm dhe i menjëhershëm në rastet kur viktima u përket kategorive veçanërisht vulnerabël, gjendet në situatë rreziku apo kur ka të dhëna për ekzistencën e viktimave të tjera;

d) të sigurohen që viktima është i identifikuar dhe njoftuar rregullisht. Në rast se ka të dhëna për viktima të tjera, të marrin masa për i identifikimin dhe njoftimin e tyre, duke i raportuar prokurorit apo kërkuar udhëzime prej tij;

dh) të trajnohen dhe të marrin njohuri të posaçme në fushën e drejtësisë penale për të miturit, nëse janë caktuar për të hetuar çështje që i përkatësin seksionit për të miturit.

3. Oficerët e policisë gjyqësore, në rastet e veprave penale të kryera ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore, të mitur apo viktimave të dhunës në familje, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme të parashikuara në ligj për mbrojtjen viktimave si dhe duhet të përdorin diskrecionin dhe gjykimin e tyre të kujdesshëm gjatë vlerësimit të kërcënimeve ndaj viktimës dhe mundësive që ekzistojnë për mbrojtjen e saj. Ata duhet të marrin në konsideratë problemet e sigurisë së viktimës gjatë gjithë procedimit penal dhe duhet të konsultohen e të koordinojnë me Policinë e Shtetit, Shërbimin e Provës, autoritetin e burgjeve dhe agjenci të tjera që kanë polici gjyqësore, me qëllimin për të plotësuar nevojat për siguri të viktimës. Nga ana tjetër, Policia e Shtetit, punonjësi i policisë gjyqësore duhet të referojnë tek prokurori i çështjes çdo shqetësim lidhur me sigurinë e viktimës, si dhe çdo kallëzim apo provë për kërcënime të mundshme ndaj saj. Viktima duhet të informohet për mënyrat që mund të jenë të disponueshme për të garantuar sigurinë e saj. Përgjegjësia për të siguruar mbrojtje fizike të arsyeshme dhe të përshtatshme për viktimën, sipas vlerësimit të bërë në bashkëpunim me prokurorin, i ngelet Policisë së Shtetit gjatë gjithë procesit penal.

4. Përsa i përket viktimave të dhunës në familje, oficerët e policisë gjyqësore që në momentet e para të marrjes së kallëzimit apo dokumentimit të ngjarjes kriminale të bashkëpunojnë me Specialistët e Policimit në Komunitet në Policinë e Shtetit për të mundësuar dhe paraqitur në Gjykatë kërkesat përkatëse për lëshim të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 9669, datë

18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar, si dhe ky dokumentacion të mundësohet që të bëhet pjesë e materialit të referuar në prokurori.

5. Oficerët e policisë gjyqësore, në veprimet e para hetimore, për të siguruar mbrojtjen e i nteresave të viktimave, si dhe për të parandaluar kryerjen e veprave të njëjta apo më të rënda penale, të vlerësojnë rast pas rasti mundësinë e zbatimit me efikasitet të masave të arrestit në flagrancë apo ndalimit me i iniciativë të autorëve të dyshuar të veprës penale, sipas kriterëve të K.Pr.Penale, duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprës apo autorit të saj, si dhe menjëherë të njoftojnë prokurorin e gatshëm të seksionit përkatës të prokurorisë.

6. Në rastet e kallëzimeve penale apo ngjarjeve kriminale që kanë të bëjnë me vepra penale të dhunës me bazë gjinore, ndaj të miturve apo që kanë të bëjnë me dhunën në familje prokurori i gatshëm duhet që :

- Në rastet e gadishmërisë të sigurojnë në mënyrë sa më eficiente komunikimin me oficerët e policisë gjyqësore që marrin kallëzimet penale apo dokumentojnë ngjarjen gjatë veprimeve të para hetimore, duke i orientuar ata në kryerjen e veprimeve të para hetimore dhe mbledhjen e provave.
- Prokurorët, në bashkëpunim me oficerët e policisë gjyqësore dhe personelin e prokurorisë kanë detyrimin të mbrojnë jetën dhe shëndetin e viktimës, si pjesë e të drejtës së saj kushtetuese për jetë, duke përdorur diskrecionin dhe gjykimin e tyre të kujdesshëm gjatë vlerësimit të kërcënimeve ndaj viktimës dhe mundësive që ekzistojnë për mbrojtjen e saj. Ata duhet të marrin në konsideratë problemet e sigurisë së viktimës gjatë gjithë procedimit penal dhe duhet të konsultohen e të koordinojnë me Policinë e Shtetit, Shërbimin e Provës, autoritetin e burgjeve dhe agjenci të tjera që kanë polici gjyqësore, me qëllimin për të plotësuar nevojat për siguri të viktimës. Viktima duhet të informohet për mënyrat që mund të jenë të disponueshme për të garantuar sigurinë e saj.

7. Prokurori duhet të marrë vetë ose udhëzon Policinë e Shtetit për marrjen e masave të arsyeshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur viktimën nga i pandehuri, nga persona që veprojnë në bashkëpunim me të apo në emër të tij. Arsyeshmëria dhe përshtatshmëria kanë të bëjnë me nivelin e mbrojtjes që u përshtatet rrethanave të rastit dhe nivelit të rrezikut, të cilat, sipas vlerësimit dhe

analizës së kryer në bashkëpunim mes prokurorit dhe Policisë së Shtetit, i përgjigjen nevojës së ngutshme për siguri, brenda burimeve financiare dhe njerëzore të secilës agjenci. Masa të tilla mund të jenë, ndër të tjera:

- a) shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë midis viktimës dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit;
- b) bërja e kërkesës për nxjerrjen e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje, urdhri mbrojtjeje ose urdhri kufizimi në gjykatë;
- c) bërjen e kërkesës për vendosjen ndaj të akuzuarit të një mase sigurimi i zoluese apo të një mase sigurimi me kushtin e ndalimit të kontaktit me viktimën;
- ç) bërjen e kërkesës për dhënien e statusit të dëshmitarit me i dentitet të fshehur;
- d) rekomandimin për pranimin e viktimës që është edhe dëshmitar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve;
- dh) marrjen e masave për mbrojtjen fizike të viktimës.

8. Në kërkesat e tyre për dhënien e dënimit për të pandehurit e akuzuar për veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, ndaj të miturve apo me dhunën në familje, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të viktimës, prokurorët duhet të vlerësojnë ashpërsimin e masave të dënimit duke pasur parasysh rrezikshmërinë e veprës, përhapjen saj, autorit, mundësinë e përsëritjes së veprës penale apo kryerjes prej autorit të një vepre penale më të rëndë.

9. Në rastet kur nga oficerët e policisë gjyqësore referohen materiale hetimore për vepra penale që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, ndaj të miturve apo për dhunën në familje, në të cilat personi i dyshuar është në gjendje të lirë, prokurori cështjes duke ushtruar dilijencën maksimale mbi rrethanat e cështjes, rrezikshmërinë e të dyshuarit dhe intesitetin e konfliktit mes viktimës dhe të dyshuarit, duhet të vlerësojë maksimalisht, rast pas rasti, ushtrimin e kompetencave procedurale për ndalimin e të dyshuarit ose t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për caktimin e masës shtrënguese ndaj të hetuarit, me qëllim që vecanërisht të evitohet kryerja e një krimi tjetër nga ky person.

10. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve të zbatojnë me rigorozitet detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi rolin e koordinatorit për subjektet me status të posacëm.

11. Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.

12. Ngarkohet Drejtuesi i Seksionit për drejtësinë penale për të mitur, ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë për të ndjekur zbatimin e përcaktimeve të këtij urdhëri dhe detyrimeve të tjera ligjore dhe nënligjore nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve. Në cdo rast ky Drejtuesi i Seksionit informon me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë për problematikat e hasura.

13. Drejtuesi i Seksionit për drejtësinë penale për të mitur, ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në zbatim të udhëzimit nr.12, dt.20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të kërkojë informacione për çështje konkrete nga prokurorët dhe të nxjerrë konform ligjit, udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për çështjet penale që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, ndaj të miturve apo për dhunën në familje.

14. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan dhe pranë shërbimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe Komisaritet e Policisë Elbasan, Gramsh, Peqin, Cërrik, Librazhd si dhe pranë të gjitha shërbimeve të policisë gjyqësore në institucione të tjera. Një kopje e këtij udhëzimi i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.

15. Një kopje e këtij urdhëzimi i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për publikim në zbatim të nenit 46/5 të ligjit nr.97/2016.

16. Ky udhëzim hyn në fuqi sot në datë 27.05.2021.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**KRESHNIK AJAZI**



A circular official stamp in blue ink is located at the bottom right of the page. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE', 'PROKURORIA SHQIPËRE', 'SHKALLËS SË PARË', and 'ELBASAN'. The stamp is partially obscured by the handwritten signature of Kreshnik Ajazi.